

Mbi vaksinimin mbrojtës kundër influencës (“gripit”)

Sëmundjet akute të rrugëve të frymëmarrjes i përkasin sëmundjeve më të shpeshta të njeriut. Ato shkaktohen nga një numër i madh patogjenësh të ndryshëm, veçanërisht nga viruset. Një rol të veçantë luan virusi i influencës, patogjeni i gripit të “vërtetë”. Roli i veçantë i gripit është i kushtëzuar nga shfaqja e tij epidemike e përvitshme. Veç kësaj, viruset e gripit, në krahasim me patogjenë të tjerë të sëmundjeve akute të rrugëve të frymëmarrjes, shkaktojnë një ecuri më të vështirë të sëmundjes. Mbrojtja më e mirë konsiston në kryerjen e një vaksinimi në kohën e duhur. Vaksinimi kundër gripit nuk na mbron nga sëmundjet akute të rrugëve të frymëmarrjes të shkaktuara nga patogjenë të tjerë, sëmundje këto, që në përgjithësi kalojnë lehtë.

Influenca është një sëmundje akute e rrugëve të frymëmarrjes, e cila shoqërohet me temperaturë, kollë e dhimbje muskujsh dhe jo gjithmonë mund të dallohet nga sëmundjet e tjera të rrugëve të frymëmarrjes vetëm nëpërmjet simptomave klinike. Kryesisht tek të moshuarit dhe tek të sëmurët kronikë vërehen shpesh ecuri të vështira të gripit. Virusit i gripit shfaqet më shpesh në stinën e ftohtë. Prandaj si rregull duhet të vaksinohemi në muajt e vjeshtës. Megjithatë, vaksinimi mbrojtës mund të kryhet në çdo kohë. Viruset e gripit ndryshojnë vazhdimisht, kështu që edhe ata që e kanë kaluar gripin apo janë vaksinuar një vit më parë, në vitin pasardhës mund të sëmuren përsëri me grip. Pra, vaksinimi ndaj gripit duhet të përsëritet çdo vit me një vaksinë aktuale.

Vaksina

Vaksina kundër gripit prodhohet çdo vit sipas rekomandimeve aktuale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), e ashtuquajtura **vaksinë sezonale**. Rekomandimi merr parasysh viruset e influencës të tipit A dhe B, që qarkullojnë në të gjithë botën në atë periudhë. Zakonisht vakcina përmban përbërës nga dy viruse të influencës A (A/H1N1 dhe A/H3N2) dhe një virus të influencës B. Në distanca më të mëdha kohore kanoset rreziku i përhapjes në të gjithë botën i një patogjeni krejtësisht të ri të gripit (Pandemia). Një rast i tillë ishte ai i “influençës së re A/H1N1”, i shfaqur në vitin 2009, që e quanin edhe si “gripit i derit”. Por ndërkohë, ky patogjen ka zëvendësuar viruset e gripit A/H1N1 që qarkullonin më parë dhe për këtë arsye është përfshirë si një nga përbërësit në vaksinën aktuale sezonale të influencës. Edhe nëse në raste përjashtimore në një sezon përbërja e vaksinës nuk ndryshon, mbrojtja nga vakcina duhet të freskohet, pasi kohëzgjatja e mbrojtjes nga vakcina mund të jetë më e vogël, veçanërisht tek të moshuarit dhe tek personat me probleme të mëparshme shëndetësore.

Vaksinat e paaktivizuara (vaksinat e vdekura) përmbajnë përbërës nga virusi i influencës, të cilët japin një mbrojtje përpara sëmundjes. Ato prodhohen ose me bazë veze pule ose edhe në kultura qelizore (këto vakcina lejohen për të rritur mbi 18 vjeç).

Vaksinat zakonisht merren përmes injeksionit intramuskular, pra injektohen në muskulin e krahut. Një vaksinë (për persona mbi 60 vjeç) injektohet edhe në lëkurë (dozë intradermale). Vaksinimi ndaj gripit mund të bëhet njëkohësisht me vakcina të tjera. Fëmijët në moshën 6 deri 35 muajsh marrin një dozë vaccine prej 0,25 ml; fëmijët mbi 36 muajsh, adoleshentët dhe të rriturit marrin një dozë vaccine 0,5 ml. Deri tani fëmijët e pavaksinuar bëjnë 2 vaksinime me një distancë kohore prej të paktën 4 javësh. Mbrojtja nga vaksinimi fillon 2 deri 3 javë pas vaksinimit.

Kush duhet të vaksinohet?

Vaksinimi kundër gripit u rekomandohet të gjithë personave, të cilët janë të rrezikuar veçanërisht nga gripin, si:

- personat mbi 60 vjeç
- të gjitha gratë shtatzëna që prej tremujorit të 2-të të shtatzënisë (në raste të një rrezikshmërie më të lartë shëndetësore si pasojë e një sëmundjeje bazë, që prej tremujorit të 1-rë)
- personat, të cilët për shkak të profesionit të tyre, janë përditë në kontakt me shumë njerëz, si për shembull shoferët e autobusëve apo mësuesit.
- banuesit në shtëpitë e të moshuarve dhe në shtëpitë e përkujdesjes shëndetësore për të moshuar.
- të rriturit, adoleshentët dhe fëmijët që rrezikohen më shumë nga ana shëndetësore si pasojë e një sëmundjeje bazë, si sëmundjet kronike në rrugët e frymëmarrjes, sëmundjet kronike kardiovaskulare, sëmundjet e mëlçisë dhe veshkave, të metabolizmit (p.sh. diabeti), dëmtime të lindura dhe të fituara të sistemit imunitar (p.sh. infeksioni HIV), sëmundjet kronike neurologjike (p.sh. skleroza multiple)
- personat, të cilët mbikëqyrin persona të rrezikuar dhe mund t'i infektojnë edhe ata me grip, por që edhe vetë janë mjaft të rrezikuar nga pacientët dhe ata që kanë nevojë për përkujdesje; këtu përfshihet personeli mjekësor dhe personeli i përkujdesjes për të moshuarit dhe të sëmurët
- personat që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me shpendë dhe zogj të egër.

Rekomandimi i vaksinimit për gratë shtatzëna u përditësua, pasi studimet treguan se gratë shtatzëna kanë qartazi një probabilitet më të lartë për të shfaqur komplikacione nga sëmundja e gripit. Efekte anësore të padëshiruara nuk janë vënë re as te nëna, as te fëmija.

Kush vuan nga sëmundje kronike neurologjike, si për shembull nga sëmundjet neuromuskulare, ka gjithashtu një probabilitet më të lartë për gjendje të rëndë shëndetësore nga gripin (edhe fëmijët). Prandaj, edhe këta pacientë duhet të vaksinohen, ashtu si edhe pacientët me skleroza multiple, tek të cilët influenza mund të çojë në rëndim të sëmundjes.

Kush nuk duhet të vaksinohet?

Kush vuan nga një sëmundje akute me temperaturë, që ka nevojë për trajtim, nuk duhet të vaksinohet. Vaksinimi duhet të bëhet më pas (pas shërimit), në momentin më të parë të mundshëm.

Kush vuan nga një hipersensitivitet i rëndë ndaj përbërësve të vaksinës nuk duhet të vaksinohen me këtë vaksinë. Ky mund të jetë rasti, p.sh. i një alergjie të rëndë nga veza e pulës. Këta pacientë duhet të pyesin mjekun e tyre, nëse është e disponueshme si alternativë një vaksinë e prodhuar jo me bazë veze pule (proteine).

Sjellja pas vaksinimit

I vaksinuari nuk ka nevojë për pushim të veçantë, megjithatë për 3 ditë pas vaksinimit duhet të shmangen sforcimet fizike të panevojshme. Personat që prirën të kenë reaksione të qarkullimit të gjakut apo tek të cilët janë konstatuar alergji të tipit të menjëhershëm, para vaksinimit duhet të njoftojnë mjekun për këtë gjë.

Reaksionet e mundshme lokale dhe të përgjithshme pas vaksinimit

Pas vaksinës, përveç synimit të rritjes së imunitetit dhe në këtë mënyrë mbrojtjes nga sëmundja, në disa raste mund shfaqen skuqe ose ënjtje me dhimbje. Ky reagim është tregues i përballjes normale të trupit me vaksinën dhe ndodh kryesisht brenda 1 deri 3 ditëve dhe rrallë zgjat më shumë. Në disa raste enjten dhe forcohen nyjat limfatike që ndodhen pranë vendit të vaksinimit. Gjithashtu mund të

shfaqen simptoma të përgjithshme, si temperaturë, ethe, të përziera, gjendje plogështie, diarre, lodhje, djersitje, dhimbje koke, dhimbje muskujsh dhe gjymtyrësh.

Reaksionet e përgjithshme të përmendura së fundmi mund të jenë arsyeja që vaksinimi kundër gripit është parë si përgjegjës, në mënyrë të gabuar, për shfaqjen e sëmundjeve të ngjashme me gripin në kohën e vaksinimit. Zakonisht këto reaksione lokale dhe të përgjithshme që përmenden janë të përkohshme, largohen shpejt dhe pa pasoja.

A janë të mundshme komplikacionet nga vaksinimi?

Komplikacionet nga vaksinimi janë pasoja shumë të rralla të vaksinimit, që shkojnë përtej një reaksioni normal, pasoja këto që rëndojnë dukshëm gjendjen shëndetësore të personit që do të vaksinohet. Pas vaksinimit kundër gripit shumë rrallë janë vërejtur reaksione alergjike të lëkurës (në disa raste me kuarje dhe me urtikarie) dhe të rrugëve të frymëmarrjes. Gjithashtu shumë rrallë mund të shfaqet një inflamacion vaskular (te vaksina me kulturë qelizore, me shumë mundësi në lidhje me përfshirjen kalimtare të veshkave) ose mund të zvogëlohet në mënyrë kalimtare numri i rruazave të kuqe dhe si pasojë mund të shfaqen hemorragji. Për një reaksion të menjëhershëm alergjik (shok alergjik) është raportuar vetëm në raste shumë të rralla.

Efekte anësore neurologjike (në sistemin nervor) të shkaktuara nga vaksinimi, p.sh. paralizë kalimtare, në kontekst kohor me vaksinimin janë raportuar në raste të rralla, ndërsa në kontekst shkakor, arsyet e efekteve neurologjike nuk janë të sigurta.

Këshillimi lidhur me efektet e mundshme anësore me mjekun e vaksinimit

Përveç kësaj fletëpalosjeje, mjeku juaj ju ofron një bisedë informuese.

Nëse pas një vaksinimi shfaqen simptoma që i tejkalojnë reaksionet e përkohshme lokale dhe të përgjithshme të sipërpërmendura, mjeku i vaksinimit sigurisht që është gjithashtu në dispozicionin tuaj.

Ju mund të kontaktoni me mjekun e vaksinimit:

Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie

Përkthimi i origjinalit të fletës informuese (versioni: 06/2015) është kryer me lejen e Deutsches Grünes Kreuz e.V. me kërkesë të Institutit Robert Koch. Teksti gjermanisht ka përparësi. Për gabime të mundshme në përkthim nuk mund të mbahet asnjë përgjegjësi, aq më pak për aktualitetin e përkthimit në fjalë në raste të rishikimeve të mëvonshme sezonale të materialit në gjuhën gjermane.

Emri _____

Name

Vaksinimi mbrojtës kundër gripit*Schutzimpfung gegen Influenza*

Bashkëlidhur gjeni një fletëpalosje mbi kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër gripit. Aty përfshihen të dhënat kryesore mbi sëmundjet që shmangen nëpërmjet vaksinimit, mbi vaksinën, vaksinimin, si dhe reaksionet dhe komplikacionet e mundshme nga vaksinimi.

Anliegend erhalten Sie ein Merkblatt über die Durchführung der Schutzimpfung gegen Influenza. Darin sind die wesentlichen Angaben über die durch die Impfung vermeidbare Krankheit, den Impfstoff, die Impfung sowie über Impfreaktionen und mögliche Impfkomplicationen enthalten.

Para kryerjes së vaksinimit kërkohen të dhënat shtesë si më poshtë:

Vor der Durchführung der Impfung wird zusätzlich um folgende Angaben gebeten:

1. A gëzon aktualisht shëndet të plotë personi që do të vaksinohet?

Ist der Impfling gegenwärtig gesund?

Po (Ja)

Jo (Nein)

2. Është konstatuar te pacienti ndonjë alergji – veçanërisht nga proteina e vezës së pulës?

Ist bei dem Patienten eine Allergie – insbesondere gegen Hühnereiweiß – bekannt?

Po (Ja)

Jo (Nein)

nëse po, cila _____

wenn ja, welche

3. Janë shfaqur tek personi që do të vaksinohet shenja alergjie, temperaturë e lartë apo ndonjë reaksion i pazakontë pas një vaksinimi të mëparshëm?

Traten bei dem Impfling nach einer früheren Impfung allergische Erscheinungen, hohes Fieber oder andere ungewöhnliche Reaktionen auf?

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth vaksinimit mbrojtës kundër gripit, pyesni mjekun e vaksinimit!

Falls Sie noch mehr über die Schutzimpfung gegen Influenza wissen wollen, fragen Sie den Impfarzt!

Në takimimin për vaksinimin ju lutemi të merrni me vete kartelën e vaksinimit!

Zum Impftermin bringen Sie bitte das Impfbuch mit!

Deklaratë miratimi*Einverständniserklärung***mbi kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër gripit***zur Durchführung der Schutzimpfung gegen Influenza*

Emri i personit që do të vaksinohet _____

Name des Impflings

Lindur më _____

geb. am

Unë u njoha me përmbajtjen e fletëpalosjes dhe në një bisedë me mjekun/mjeken time u informova në mënyrë të detajuar mbi vaksinimin.

Ich habe den Inhalt des Merkblatts zur Kenntnis genommen und bin von meinem Arzt/meiner Ärztin im Gespräch ausführlich über die Impfung aufgeklärt worden.

 Unë nuk kam pyetje të tjera.*Ich habe keine weiteren Fragen.* Unë e pranoj vaksinimin e propozuar kundër gripit.*Ich willige in die vorgeschlagene Impfung gegen Influenza ein.* Unë e refuzoj vaksinimin. U vura në dijeni për anët negative të mundshme të refuzimit të vaksinimit.*Ich lehne die Impfung ab. Über mögliche Nachteile der Ablehnung dieser Impfung wurde ich informiert.*

Shënime Vermerke _____

Vendi, data Ort, Datum _____

Nënshkrimi i personit që do të vaksinohet
ose i kujdestarit të tij*Unterschrift des Impflings bzw. des Sorgeberechtigten*_____
Nënshkrimi i mjekut/mjekes*Unterschrift des Arztes/der Ärztin*